

URDHËR
Nr. 9, datë 29.1.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të neneve 27 dhe 29, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Financave, në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatin e Ministrisë së Financave, nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit, që do të përfaqësojë ministrinë.

3. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Financave, në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

4. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Financave në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, gjatë seancës përkatëse të gjykimit, me përjashtim të nënshkrimit të akteve procedurale të tilla si, por pa u kufizuar: kërkesë-padi, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi.

5. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdoruar ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit të ministrit të Financave nr. 35, datë 17.3.2009, shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe struktura përgjegjëse për çështjet juridike në Ministrinë e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani